

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës duke u bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga 4iG Tavkozlesi Holding Zartkoruen Mukodo Reszvenitarsasag, shoqëri aksionare me seli të regjistruar në rr. Krisztina korut nr. 39, 1013 Budapest, Hungari, dorëzuar përmes Ivana Jeftiq Nikolova, avokate nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 20.08.2025, solli këtë:

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin 4iG Tavkozlesi Holding Zartkoruen Mukodo Reszvenitarsasag, shoqëri aksionare me seli të regjistruar në rr. Krisztina korut nr. 39, 1013 Budapest, Hungari, do të fitojë kontroll mbi Netfone Telekom Tavkozlesi es Szolgaltato Felelossegu Tarsasag, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në rr. Nefelejcs nr. 2/A, 8900 Zalaegerszeg, Hungari, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në shumë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria për pagesë 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 05.08.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), u dorëzua njoftim për përqendrim nga ana e 4iG Tavkozlesi Holding Zartkoruen Mukodo Reszvenitarsasag, shoqëri aksionare me seli të regjistruar në rr. Krisztina korut nr. 39, 1013 Budapest, Hungari, me të cilin 4iG Tavkozlesi Holding Zartkoruen Mukodo Reszvenitarsasag do të fitojë kontroll mbi Netfone Telekom Tavkozlesi es Szolgaltato Felelossegu Tarsasag, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në rr. Nefelejcs nr. 2/A, 8900 Zalaegerszeg, Hungari, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit me ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, dhe shtojcave të tij, konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

4iG Tavkozlesi Holding Zartkoruen Mukodo Reszvenitarsasag është shoqëri aksionare, e regjistruar për veprimtari kryesore të kompanive holding, telekomunikimeve dhe integritet të sistemeve IT, teknologjive hapësinore dhe të mbrojtjes, shërbimeve radio-difuzive dhe satelitore.

4iG Tavkozlesi Holding Zartkoruen Mukodo Reszvenitarsasag ka një subjekt juridik të lidhur në Maqedoninë e Veriut, dhe ai është Shoqëria për shërbime komunikimi ONE MAKEDONIJA TELEKOMUNIKACII SHPKNJP Shkup, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me seli në rr. Crvena Voda numër 7/3, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, veprimtaria prioritare e së cilës është 61.20 – veprimtari të telekomunikimeve pa tela.

Netfone Telekom Tavkozlesi es Szolgaltato Felelossegu Tarsasag, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, një operator virtual mobil hungarez (MVNO) i cili ofron shërbime celulare, VoIP dhe internet duke përdorur infrastrukturën e operatorëve kryesorë të rrjetit, me fokus në paketa tarifore fleksibile dhe rrjet për shitje direkte. Veprimtaria e saj kryesore është veprimtaria e telekomunikimeve me tela, pa tela dhe satelitore. Netfone Telekom Tavkozlesi es Szolgaltato Felelossegu Tarsasag nuk ka subjekte të lidhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, sepse plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe pika 2) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ